

UDHËZIM
Nr.1456, datë 28.7.2009

**PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR LICENCIM, TË
SUBJEKTEVE QË KRYEJNË VEPRIMTARI TË PËRKUJDESIT SHOQËROR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 18 pika 1 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 5 kreu II dhe pikës 4 kreu XI të vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta” të Këshillit të Ministrave,

UDHËZOJ:

1. Kërkesat e subjekteve fizike/juridike, ofruese të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, që kanë aplikuar pranë sporteleve të Qendrës Kombëtare të Licencimeve (QKL) për t’u pajisur me licencë për ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe janë miratuar në fazën e parë, kalojnë në mënyrë elektronike pranë Drejtorisë së Politikave të Shërbimeve Sociale, pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

2. Personi përgjegjës pranë kësaj drejtorie bën regjistrimin e kërkesës dhe të dokumentacionit të ardhur në regjistrin elektronik të krijuar për këtë qëllim dhe i përcjell ato në Shërbimin Social Shtetëror brenda 3 ditëve pune nga marrja e tij.

3. Shërbimi Social Shtetëror:

a) shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, i cili përfshin dokumentet provuese sipas aneksit 1 fusha X kategoria X.1.B bashkëngjitur vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta” të Këshillit të Ministrave, dhe dokumentet provuese që lidhen me drejtuesin teknik, sipas përcaktimit të germës “a” pika 4 kreu III të këtij vendimi;

b) bën inspektimin në vend të shërbimit që ofron subjekti. Inspektimi në vend përfshin kontrollin e cilësisë së shërbimeve nëse subjekti ofron shërbim, plotësimin e standardeve sipas natyrës së shërbimeve, kriterëve përkatëse të licencimit sipas kategorisë X.1, III.7 të vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit” të Këshillit të Ministrave.

4. Në rast se gjatë inspektimit vihen re shkelje, pasaktësi të dokumentacionit, mosplotësim i standardeve apo mospërputhje me deklaratimet e bëra në formularin e vetëdeklarimit, Shërbimit Social Shtetëror i kërkon subjektit plotësimin e mangësive të konstatuara, brenda 5 ditëve pune. Nëse këto mangësi nuk plotësohen brenda këtij afati, Shërbimi Social Shtetëror i propozon komisionit të shqyrtimit të kërkesave për licencim pranë MPÇSSHB të mos miratojë kërkesën e subjektit për t’u pajisur me licencë.

5. Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës dhe kryerjes së inspektimit në vend, Shërbimi Social Shtetëror dërgon në Drejtorinë e Politikave të Shërbimeve Sociale në MPÇSSHB, brenda 17 ditëve pune nga momenti i marrjes së dokumentacionit nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

a) dokumentacionin që ka paraqitur aplikuesi;

b) vlerësimin e Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës së Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore.

6. Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale informon me shkrim kryetarin e komisionit të shqyrtimit të kërkesave për licencë, duke i propozuar datën për mbledhjen e komisionit. Kryetari i komisionit vendos për datën e mbledhjes së komisionit.

7. Komisioni i shqyrtimit të kërkesave për licenca kryesohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe përbëhet nga 6 anëtarë, të cilët janë përfaqësues nga:

- a) Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale;
- b) Drejtoria e Shërbimeve Juridike;
- c) Shërbimi Social Shtetëror;
- ç) 2 përfaqësues të OJF-ve.

Ngritja e komisionit dhe caktimi i anëtarëve të tij bëhet me urdhër të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

8. Komisioni i shqyrtimit të kërkesave për licencë, pasi bën vlerësimin e dokumentacionit, vendos:

- a) miratimin e kërkesës për pajisje me licencë;
- b) refuzimin e kërkesës për pajisje me licencë.

9. Në rast se kërkesa miratohet, vendimi miratues, së bashku me arsyetimin ligjor përkatës përcillet në Qendrën Kombëtare të Licencimit, e cila pajis me licencë subjektin ofrues të shërbimeve të përkujdesit rezidencial me kodin X.1.B.

10. Në rast se kërkesa refuzohet, komisioni harton me shkrim arsyetimin ligjor përkatës, në të cilin përcaktohen qartë shkaqet e refuzimit, dhe ia dërgon Qendrës Kombëtare të Licencimit.

11. Nëse subjekti nuk është dakord me vendimin e marrë nga komisioni i shqyrtimit të kërkesave për licencë, për refuzimin e kërkesës për licencim, ai ka të drejtën e ndjekjes së procedurës së ankimimit sipas nenit 30 të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 brenda 10 ditëve pune nga dita e marrjes së njoftimit për refuzimin e kërkesës.

12. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shqyrton ankimimin dhe merr vendim brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të tij. Në rast se ky afat tejkalohet, si dhe në rastet kur ministri lë në fuqi vendimin për mosmiratimin e kërkesës për licencë, subjekti fizik/juridik i drejtohet gjykatës brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit të shqyrtimit të ankimimit.

13. Për pajisjen me licencë për veprimtari të përkujdesit shoqëror, përveç tarifës së QKL-së, subjekti detyrohet të paguajë tarifën prej 10 000 lekësh pranë MPÇSSHB-së, e cila derdhet në llogarinë bankare të këtij institucioni. Një kopje e faturës paraqitet pranë sporteleve të QKL-së, në çastin e marrjes së licencës. Këto të ardhura përdoren nga MPÇSSHB-ja sipas legjislacionit në fuqi.

14. Pas licencimit nga Qendra Kombëtare e Licencimit, subjektet e licencuara i nënshtrohen një kontrolli periodik, jo më pak se dy herë në vit, i cili kryhet nga struktura përkatëse e Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror dhe/ose rajonal, sipas planit të punës së miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së.

15. Nëse gjatë kontrollit të subjekteve të licencuara konstatohet se janë paraqitur deklarime të rreme, nuk janë respektuar standardet e kërkuara ose veprimtaria kryhet jo në përputhje me legjislacionin në fuqi, Inspektorati i Kontrollit i propozon komisionit të shqyrtimit të kërkesave për licencim të vendosë lidhur me revokimin e licencës. Bazuar në vendimin e komisionit, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta kërkon nga QKL-ja revokimin e licencës.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Viktor Gumi